



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
K R Y E S I A

Nr. 19 prot.

Tiranë, më 07 01.2020

V E N D I M

Nr. 3, datë 07.01.2020

**Për vijim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për titullin
akademik dhe akademik i asociuar**

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 07.01.2020, në mbështetje të Ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, neni 6 pika 2; konform Statutit organik të saj; referuar vendimit nr. 37, datë 11.11.2019 Për shpalljen e vendeve të lira për pranime të reja në Asamble sipas fushave përkatëse; thirrjes publike për pjesëmarrje në konkurrim, si dhe relacionit nr. 514, datë 27 dhjetor 2019 të komisionit teknik për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët,

V e n d o s i :

1. Të miratojë vijimin e procedurës së konkurrimit për kandidatët që aplikojnë për titullin akademik dhe akademik të asociuar:

Nr.	Emri e mbiemri	Fusha	Titulli i kërkuar
1.	Prof. Kristina Jorgaqi Jano	Gjuhësi	Akademik i asociuar
2.	Prof. Genc Sulçebe	Mjekësi	Akademik i asociuar
3.	Prof. Artan Boriçi	Fizikë	Akademik i asociuar
4.	Prof. Mimoza Hafizi	Fizikë	Akademik i asociuar
5.	Prof. Pëllumb Xhufi	Histori	Akademik
6.	Prof. Rrapo Ormeni	Gjeofizikë	Akademik i asociuar
7.	Prof. Adrian Civici	Ekonomi	Akademik i asociuar
8.	Prof. Raimonda Bulhaljoti Çako	Inxhinieri	Akademik i asociuar
9.	Prof. Ilia Mikerezi	Biologji	Akademik

2. Duke qenë se, sipas relacionit të komisioni teknik, për mospërputhje midis fushës së aplikimit nga prof. dr. Ardian Ndreca dhe fushave të reja të hapura; si dhe duke iu referuar nenit 6 pika 3 të Ligjit nr. 53/2019, i rekomandohet Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të fillojë procedurën e propozimit të kandidaturës së tij si *anëtar i jashtëm*.
3. Komisioni teknik të përshpejtojë punën dhe të plotësojë dosjet e kandidatëve, në përputhje me afatet ligjore, brenda datës 15 janar 2020, me përgjigjet e institucioneve përgjegjëse për dekriminalizimin dhe pastërtinë e figurës.
4. Sekretari Shkencor t'u drejtohet për vlerësim njëjësive bazë dhe Senateve akademike ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre kandidatët. Ky proces të mbyllet brenda datës 15 shkurt 2020.
5. Komisionet dhe seksionet përkatëse të zbatojnë detyrat e tyre për vlerësim dhe vendim sipas nenit 7, pikat 8-9 të Statutit brenda datës 15 mars 2020.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

